

Në vijim të kërkesës suaj të datës 28.10.2025, me anën e së cilës kërkonti informacion mbi domainin “valanews.al”, ju bëjmë me dije sa më poshtë:

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) administron domainin “.al”, bazuar në shkronjën dh) të pikës 2 të nenit 12 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Rregulloren nr. 2, datë 21.02.2008 “Për regjistrimin dhe administrimin e emrave të domaineve nën .al”, e ndryshuar.

Për sa i përket pyetjes tuaj të parë, ju informojmë se domaini valanews.al është i regjistruar dhe aktiv në sistemin e domaineve .al.

Në lidhje me pyetjen e dytë, për të dhënat e kontaktit të këtij domaini, ju bëjmë me dije se, bazuar në pikën 32.1 të nenit 32 të Rregullores nr. 2 të sipërcituar, të dhënat e depozituara në AKEP nga aplikuesit e domaineve .al konsiderohen konfidenciale dhe nuk mund t’u kalohen palëve të treta. Përjashtim bëjnë rastet kur dhënia e informacionit nga AKEP përbën detyrim ligjor, ose kur i interesuari e kërkon informacionin me qëllim ngritjen e një padie.

Sipas pikës 32.2 të nenit 32 të Rregullores, AKEP do t’i sigurojë organit që do të merret me zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ose personit të autorizuar prej tij, të gjithë informacionin e kërkuar dhe, në mënyrë të veçantë, të dhënat që lidhen me emrin e domain-it në fjalë. Në të kundërt, AKEP, në zbatim të pikës 32.3 të të njëjtit nen, dhe duke mos qënë në kundërshtim me legjislacionin përkatës në fuqi, do të respektojë në çdo rast të drejtën e poseduesit të domainit për ruajtjen e privatësisë.

Në përputhje me sa më sipër dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 124/2024 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, informacioni i kërkuar për poseduesin e domainit “valanews.al” mund t’u jepet vetëm institucioneve ligjzbatuese përkatëse.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

Me respekt,